



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Miratuar me Vendimin Nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s
Ndryshuar me Vendimin nr. 232, datë 03.11.2016 të AMA-s

**RREGULLORE PËR
PROCEDURAT DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS SË TRANSMETIMIT AUDIO**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audio, në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 2
Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 3
Llojet e licencave të transmetimit audio**

Licencat e transmetimit audio klasifikohen në:

1. Licenca e transmetimit audio analoge që përbëhet nga:
 - a. licenca e shërbimit të programi audio,
 - b. licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.
2. Licenca e transmetimit audio numerike që përbëhet nga:
 - a. licenca e shërbimit të programi audio,
 - b. licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit numerik.
3. Në varësi të zonës së mbulimit me sinjal licencat e transmetimit audio sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ndahen në:
 - a. Kombëtare, kur mbulohet me sinjal jo më pak se 80 për qind e territorit të vendit;
 - b. Rajonale, për mbulim deri në 4 qarqe me vazhdimësi gjeografike;
 - c. Lokale, për mbulimin e një qarku në rastin e rrjetit numerik dhe deri në një qark në rastin e rrjetit analog.

Neni 4

Kërkesa të përgjithshme të aplikimit për licencë transmetimi audio

Aplikimi për marrjen e licencës së transmetimit audioviziv duhet të përmbajë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. Emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit që bën kërkesën bashkë me emrin dhe firmën e personit që ka të drejtë ta përfaqësojë atë.
2. Dokumentet që vërtetojnë të dhëna zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik që bën kërkesën.
3. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca dhe/ose autorizimi.
4. Emërtimin e programit dhe të rrjetit ku do të mbështetet.
5. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbulojë, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave.
6. Listën e administratorëve,
7. Listën emërore të anëtarëve të bordit drejtues dhe *curriculum vitae* të tyre.
8. Përmbajtjen e programeve që do të transmetohen në përputhje me parimet themelore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesat e Kodit të Transmetimit të AMA-s.
9. Dokumentacionin që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve (kontratë për kalimin e të drejtave të transmetimit si shitje, dhurimi ose shkëmbimi).
10. Strukturën programore të propozuar për transmetim e cila duhet të përmbajë, pavarësisht nga lloji i aplikimit për licencë kombëtare, rajonale apo lokale, të dhëna dhe raporte që, në tërësinë e tyre shprehin qartë pluralizmin dhe paanësinë e informacionit.
11. Aplikimi duhet të përfshijë informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj.
12. Aplikuesi duhet t’i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.

Neni 5

Shqyrtimi i aplikimeve

1. Shqyrtimi i aplikimeve për marrje licence kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, i ngritur me urdhër të kryetarit të AMA-s.
2. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë dhe verifikojnë përmbushjen e kriterëve ekonomike, teknike, programore etj, dhe përgatisin relacionet e vlerësimit sipas kompetencës. Rezultatet e vlerësimit me pikë i paraqiten AMA-s në një raport të shoqëruar nga një tabelë përmbledhëse ku aplikuesit renditen sipas numrit maksimal të pikëve të grumbulluara.
3. AMA miraton procedurat e ndjekura dhe vlerësimin me pikë në një mbledhje të veçantë. AMA në rast se konstaton mangësi në respektimin e procedurave dhe vlerësimit, ka të drejtë të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
4. Anëtarët e Komisionit mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet gjatë këtij procesi.
5. Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t’u bëhen të njohura aplikuesve a personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Neni 6

Vendimi për dhënien e licencës së transmetimit

1. Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencës së transmetimit audio jepet nga AMA jo më vonë se 60 ditë nga dita e aplikimit.
2. Kur AMA vendos mosmiratimin e aplikimit, duhet të njoftojë aplikuesit për:
 - a) arsyet e vendimit;
 - b) rezultatin e vlerësimit të aplikuesit;
 - c) rezultatin e aplikimit fitues.
3. Kundër vendimit të AMA-s sipas këtij neni, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas, ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KREU II

LICENCIMI I TRANSMETIMEVE AUDIO ANALOGE

Neni 7

Plani i frekuencave

AMA harton planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio analoge, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF).

Neni 8

Çelja e konkurrimit

1. Subjektet e interesuara për licencë për transmetime audio paraqesin pranë AMA-s letrën e interesit, ku përshkruhet:
 - i. Shërbimi i kërkuar (transmetim audio).
 - ii. Lloji i licencës së transmetimit (kombëtare, rajonale ose lokale).
 - iii. Zona e shërbimit.
 - iv. Prezantim i shkurtër i subjektit të interesuar.
2. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara sipas pikës 1 të këtij neni, duke pasur parasysh ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet audio analoge:
 - a) përcakton hapësirën e mbulimit të licencës së transmetimit audio, për të cilën mund të aplikohet;
 - b) çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio.
3. Për përcaktimin e hapësirës së mbulimit, AMA mban parasysh:
 - a) Interesat, pritshmëritë dhe dëshirat e publikut në këtë zonë mbulimi;
 - b) Ndikimin në sektorin e transmetimeve në këtë zonë;
 - c) Larminë e shërbimeve të programeve në zonën e mbulimit.
4. Për përcaktimin e hapësirës së mbulimit AMA organizon studimin përkatës, rezultatet e të cilit publikohen në faqen e internetit të AMA-s.

Neni 9

Shpallja e procedurës së licencimit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge në faqen e internetit të saj dhe në një organ shtypi, që shpërndahet në zonën e mbulimit të licencës së transmetimit.
2. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audio, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.
3. Aplikimet për këtë licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

Neni 10

Tërheqja e dokumentacionit të konkurrimit

1. Subjekti i interesuar për t'u pajisur me licencë transmetimi audio analoge duhet të pajiset me dokumentacionin e licencimit dhe të paraqesë aplikimin përkatës në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin për shpalljen e garës.
2. AMA miraton dokumentacionin që do t'u vihet në dispozicion subjekteve që do shfaqin interes për t'u licencuar, dokumentacion i cili tërhiqet nga zyra e protokollit të AMA-s, pas kryerjes së pagesës së pakthyeshme në masën 1.000 lekë pranë Drejtorisë Ekonomike.
3. Dokumentacioni i licencimit përfshin:
 - a. Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio"
 - b. Kushtet teknike të instalimit të pajisjeve transmetuese për secilën zonë të shpallur; (Pika e transmetimit, kanali, fuqia e transmetuesit, etj.
 - c. Kërkesat programore
 - d. Pagesat për licencën, taksat etj, e llogaritura për zonën në fjalë.

Neni 11

Sqarimet mbi dokumentacionin e licencimit

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet, që kanë blerë dokumentacionin e konkurrimit mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA për dokumentacionin e licencimit.
2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e licencimit, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjektsh, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë blerë dokumentacionin e licencimit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

Neni 12

Aplikimi

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e licencimit.
2. Çdo subjekt aplikues i nënshtrohet kërkesave të parashikuara në nenin 62 të ligjit nr. 97/2013, mbi kufizimet e pronësisë në transmetimet audio. Mosrespektimi i detyrimit sipas këtij neni është kusht skualifikimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

3. Dokumentacioni i aplikimit që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë përpara datës së aplikimit.
4. Aplikimi në çdo fletë duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
5. Dokumentacioni i aplikimit nuk i kthehet aplikuesit.

Neni 13

Kërkesa të përgjithshme

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio u jepet shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri aksionare janë nominative.
3. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.
4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.
5. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio u jepet personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
6. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.
7. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.
8. Licenca kombëtare, rajonale ose lokale e transmetimit audio nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionarë të të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca me vendim të AMA-s.
9. Licenca kombëtare, rajonale ose lokale e transmetimit audio nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.

Neni 14

Kërkesat financiare

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio u jepet shoqërive aksionare që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar, në vlerën jo më pak 10.000.000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. Licenca rajonale e transmetimit audio u jepet subjekteve juridike që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/ autorizuar në vlerën jo më pak 2.500.000 lekë.
3. Licenca lokale e transmetimit audio u jepet subjekteve juridike që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/ autorizuar dhe/ose në formën e depozitës në bankë, jo më pak se 1.000.000 lekë.
4. Subjekti aplikues duhet të paraqesë garanci bankare në masën 10% të vlerës së kapitalit financiar të kërkuar. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë prej:
 - i. 12 muajsh, për aplikimet për licencë kombëtare audio
 - ii. 6 muajsh, për aplikimet për licencë rajonale ose lokale,
5. Afati i parashikuar në pikën 4 të këtij neni fillon nga data e depozitimit të aplikimit.
6. Garancia bankare ç'ngurtësohet para afatit në rast se:
 - i. Subjekti i pajisur me licencë ka dalë në transmetim dhe ka kryer pagesën vjetore për licencë;
 - ii. Subjektit i është refuzuar aplikimi për licencë.
7. Në rast se subjekti nuk ka dalë në transmetim brenda afateve të përcaktuara në nenin 69 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe është debitor ndaj AMA-s, garancia bankare kalon në llogari të AMA-s, në masën e detyrimit.

Neni 15

Kërkesat programore

Aplikuesi për licencë kombëtare, rajonale apo lokale të transmetimit audio duhet të garantojë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tyre do të përmbushin standardet programore duke:

- i. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit.
- ii. Respektuar paanshmërinë, plotësinë e pluralizmin e informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinionëve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
- iii. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
- iv. Promovuar kulturën kombëtare shqiptare dhe gjuhën shqipe;
- v. Promovuar kulturën evropiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat evropiane;
- vi. Promovuar kulturën e pakicave kombëtare;
- vii. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, radio-dramatizimeve dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare;
- viii. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e RSH-së për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;
- ix. Promovuar bashkëpronësinë dhe kolegjalitetin në vendimmarrjet editoriale;
- x. Respektuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- xi. Respektuar privatësinë e individit;
- xii. Respektuar diversitetin fetar dhe racën;
- xiii. Respektuar ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
- xiv. Respektuar normat morale dhe etike të shoqërisë;
- xv. Respektuar të drejtën e përgjigjes.
- xvi. Respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve, në të gjitha llojet e programeve dhe në programe të posaçme audio për fëmijët.

Neni 16

Kërkesat teknike

Aplikuesit për licencë kombëtare, rajonale ose lokale duhet të plotësojnë kërkesat teknike, ku bëjnë pjesë:

- a. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit përfshirë mbulimin dhe interferencat;
 - (i) zona e mbulimit
 - (ii) të përcaktohet pika e transmetimit
 - (iii) të përcaktohet frekuenca/t e transmetimit
 - (iv) të përcaktohet fuqia/të e transmetimit
 - (v) të përcaktohet diagrama/t "H" dhe "V" të antenës/ave transmetuese
 - (vi) subjekti duhet të transmetojë sinjal RDS (sistem i të dhënave radio) në mënyrë që të identifikohet logoja e radios
 - (vii) Nëse për ofrimin e shërbimit nga studiot e subjektit deri në pikën e transmetimit do të përdoren lidhjet fikse (radiolink) subjekti duhet të aplikojë në AKEP për t'u pajisur me autorizimin përkatës.
- b. Projektin dhe preventivin e rrjetit
 - (i) skema e organizimit
 - (ii) liste e pajisjeve teknike, projektet teknike të studios/ve si dhe vendndodhja e studios; projektet teknike të pikave të transmetimit,
 - (iii) Tipi dhe karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese, hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);

Neni 17

Cilësia e shërbimit

1. Mbulim me sinjal radio FM tokësore, sipas Rekomandimit ITU-R, BS 412-9 të ITU, do të konsiderohet mbulimi i zonës së licencimit me intensitet fushe jo më të vogël se:
 - 70 dB μ V/m (mono) dhe 74 dB μ V/m (stereo) për qytete të mëdha;
 - 60 dB μ V/m (mono) dhe 66 dB μ V/m (stereo) për zona urbane;
 - 48 dB μ V/m (mono) dhe 54 dB μ V/m (stereo) për zona rurale;
 - 34 dB μ V/m (mono) dhe 48 dB μ V/m (stereo) për zona të thella të Shqipërisë.
2. Subjekti i licencuar, bazuar në standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, duhet të ofrojë shërbime audio me cilësi të lartë në zonën për të cilën është licencuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

3. Pajisjet që do të përdoren duhet të projektohen, ndërtohen, mirëmbahen dhe shfrytëzohen në mënyrë që përdorimi i tyre të mos shkaktojë asnjë interferencë të dëmshme tek asnjë përdorues tjetër i spektrit të radiofrekuencave.

Neni 18

Shfrytëzimi i spektrit të frekuencave

Subjekti i licencuar për transmetime kombëtare, rajonale ose lokale audio, për të realizuar përmirësimin e mbulimit nga rrjeti i tyre, kanë të drejtë t'i kërkojnë AMA-s, frekuenca të tjera shtesë brenda zonës së licencimit.

Neni 19

Dokumentacioni i aplikimit

1. Aplikuesi për licencë kombëtare, rajonale ose lokale transmetimi audio duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

1.1. Të dhënat e aplikuesit:

- i. Regjistrimi në QKR me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionarëve me kuotat respektive;
- ii. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë listën e ortakëve të tij;
- iii. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera audio ose audiovizive.
- iv. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve të subjektit;
- v. Adresa, nr. tel, fax, e_d. mail;
- vi. Personi përfaqësues.

1.2. Kërkesa teknike:

- i. Objektivin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit përfshirë mbulimin dhe interferencat;
- ii. Projektin dhe preventivin e rrjetit [(a) skema e organizimit, (b) projektet teknike të studiove; (c) projektet teknike të pikave të transmetimit; (d) karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese] hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);
- iii. Projektin dhe preventivin e rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP;
- iv. Afati i propozuar i përfundimit të rrjetit.

1.3 Kërkesat ekonomike:

- i. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i vërtetuar ose në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose nga një ekspert kontabël i miratuar/autorizuar;
- ii. Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat për periudhën e vlefshmërisë së licencës duke përcaktuar llojet e të ardhurave (reklama, të ardhura nga të tretët, të ardhurat nga shërbimi etj), shpenzimet fikse, të ndryshueshme, detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, origjinën dhe vlerën e investimeve që parashikohen të kryhen gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- iii. Garancia bankare që vërteton se aplikuesi ka ngurtësuar shumën prej 10% të vlerës së kapitalit financiar të kërkuar, duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit, për një periudhë deri 12 muaj për aplikimet për licencë kombëtare dhe deri në 6 muaj për aplikimet për licencë rajonale ose rajonale.
- iv. Lista e administratorëve.

1.4 Kërkesat programore:

- i. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen të jetë në përputhje me parimet themelore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesat e Kodit të Transmetimit të AMA-s.
- ii. Struktura programore e propozuar duhet të përmbajë, pavarësisht nga lloji i aplikimit për licencë kombëtare, rajonale apo lokale, të dhëna dhe raporte që, në tërësinë e tyre shprehin qartë pluralizmin dhe paanësinë e informacionit.
- iii. Të dhëna statistikore për programet audio të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe tematike (Informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, dramatizim, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
- iv. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
- v. Programi javor i transmetimit;
- vi. Grila e strukturës programore;
- vii. Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë që garanton cilësinë e informacionit, promovimin e gjuhës e të kulturës kombëtare, larminë e programeve për fëmijë e të rinj, si dhe çështje specifike të traditës e zhvillimeve rajonale e lokale.

1.5 Të tjera:

- i. Të dhëna mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë;
 - ii. Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;
 - iii. Informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj;
 - iv. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit (për subjektet rajonale dhe lokale minimumi është 5 anëtarë, ndërsa për subjektet kombëtare minimumi është 7 anëtarë).
- 2. Aplikuesi duhet t’i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.
 - 3. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.
 - 4. AMA gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit për dhënien e licencës së transmetimit audio, kërkon informacion për subjektet aplikues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Neni 20

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për licencë transmetimi

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën vlerësimin me pikë të çdo aplikimi për licencë transmetimi kombëtare, rajonale ose lokale:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. Struktura programore	20 pikë
2.1 Programe të përgjithshme	
2.1.1 Programe informative	2 njësi
2.1.2 Programe për fëmijë	3 njësi
2.1.3 Program për minoritetet	2 njësi
2.1.4 Programe edukative	3 njësi
2.1.5 Programe të aktualitetit	2 njësi
2.1.6. Radio-dramatizime	2 njësi
2.1.7 Programe argëtuese	2 njësi
2.1.8 Quiz	2 njësi
2.1.9 Programe sportive	2 njësi
2.1.10 etj	2 njësi
TOTALI	22 njësi
2.2 Programe tematike:	
2.2.1 Programe informative	5 njësi
2.2.2 Program për fëmijë	10 njësi
2.2.3 Larmia brenda tematikës	5 njësi
2.2.4 etj	2 njësi
TOTALI	22 njësi
2.3 Vlerësimi i tërësisë së programeve bëhet si më poshtë:	
Mblidhen njësitë e grumbulluara gjatë vlerësimit për shërbimin programor (të përgjithshëm ose tematik), e cila quhet shumatore e njësive (ΣN).	
Numri i njësive maksimale është 22 njësi.	
Llogaritja e pikës bëhet sipas formulës:	
$P = \Sigma N / 22 * 20$	
Llogaritja e pikëve sipas kësaj formule bëhet vetëm, ose për programin tematik, ose për programin e përgjithshëm dhe, në numrin total të pikëve, shtohet vetëm 1 shumë.	
2. Vlerësimi i aftësive teknike	40 pikë
2.1 Projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave dhe preventivi përkatës,	20 pikë
2.2. Plani i mirëmbajtjes së rrjetit	10 pikë
2.3 Projektin dhe preventivin e rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP	5 pikë
2.4. Afati i propozuar i përfundimit të rrjetit, duke specifikuar planin e implementimit	5 pikë
3. Vlerësimi i kritereve financiare	20 pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- a. Fuqia ekonomike që rezulton nga kapitali themeltar i aplikuesit 10 pikë;
 - b. Kapaciteti i vetëfinancimit gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës 5 pikë;
 - c. Investimet teknologjike që parashikohen të kryhen 5 pikë;
5. Vlerësimi i burimeve njerëzore 20 pikë, nga të cilat
- 5.1. Numri i punonjësve 8 pikë;
 - 5.2. Cv e punonjësve të firmosura, gjithëpërfshirëse 6 pikë
 - 5.3. Mënyra e organizimit (organigrama) 6 pikë;

Neni 21

Afati i licencës së transmetimit audio

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio analoge jepet për një afat 5 vjeçar.
2. Licenca rajonale dhe lokale e transmetimit audio analoge jepet për një afat 5 vjeçar.

Neni 22

Rinovimi i licencës

1. Aplikimi për rinovimin e licencës së transmetimit audio duhet të bëhet të paktën 90 ditë përpara përfundimit të afatit të licencës.
2. Kërkesat e aplikimit për rinovimin e licencës së transmetimit audio janë të njëjta me atë të aplikimit fillestar.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive refuzon aplikimin e subjektit i cili:
 - a) nuk ka respektuar kushtet e licencës gjatë periudhës së licencimit;
 - b) është debitorlidhur me detyrimeve financiare të rrjedhura nga licenca;
 - c) është debitor si rrjedhojë e dënimit me sanksion gjobë, të formës së prerë të pashlyer.

Neni 23

Zgjerimi dhe/ose zvogëlimi i zonës së licencimit

1. Kërkesat e aplikimit për zgjerimin, ose zvogëlimin e zonës së licencimit të transmetimit audio janë të njëjta me atë të aplikimit fillestar.
2. Aplikimet shqyrtohen në përputhje me planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio analoge, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF).

Neni 24

Detyrimi për daljen në transmetim

I licencuari për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal duhet të respektojë kërkesën e parashikuar në nenin 69 të ligjit nr. 97/2013, për daljen në transmetim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Neni 25

Detyrimet financiare

1. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal, do të kryhen bazuar në vendimin nr. 4, datë 22.05.2013 të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe vendimin nr. 6, datë 22.05.2013 “Për miratimin e pagesave për shërbime që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.
2. Pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatëvonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.
3. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal, mund të jenë objekt ndryshimi me vendim të Autoritetit të Mediave Audiovizive në përputhje me legjislacioni në fuqi në fushën e mediave.

KREU III

LICENCIMI I TRANSMETIMEVE AUDIO NUMERIKE TOKËSORE

Neni 26

Llojet e licencave audio numerike

- i. Licencat për transmetimet audio numerike janë:
 - 1.1. Licencë transmetimi audio e përbëra nga:
 - a) Licenca të shërbimit të programit audiodhe
 - b) Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor numerik.
 - 1.2. Licencë e shërbimit të programit audio.
2. Të drejtën e aplikimit për t’u pajisur me licencë rrjeti numerik, përkatësisht lokal, rajonal kombëtar e kanë shoqëritë që:
 - a) zotërojnë licencë për shërbime programi audio përkatësisht lokale, rajonale apo kombëtare;
 - b) nuk zotërojnë licencë për shërbime programi audio. Në këtë rast aplikimi bëhet njëkohësisht për licencë për shërbime programi.

Neni 27

Çelja e konkurrimit

1. Subjektet e interesuara për licencë për transmetime audio numerike dhe/ose për licencë për shërbim programi audio të mbështetur në rrjet numerik, paraqesin pranë AMA-s letrën e interesit, ku përshkruhet:
 - i. Shërbimi i kërkuar (transmetim audio numerik apo shërbim programi numerik).
 - ii. Lloji i licencës së transmetimit (kombëtare, rajonale ose lokale).
 - iii. Zona e shërbimit (allotmenti).
 - iv. Shërbimet e programeve që do të mbështeten në rrjetin numerik.
 - v. Prezantim i shkurtër i subjektit të interesuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara sipas pikës 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet numerike:
 - a. përcakton zonat përkatëse të mbulimit me programe, shërbime shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to;
 - b. çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio numerike dhe/ose licencës së shërbimit të programit audio.
3. Në njoftimin për çeljen e garës, AMA përcakton numrin e shërbimeve të programeve audio që do të mbështeten në multipleks, si dhe nëse ndonjë shërbim ekzistues i programeve audio do të mbështetet në rrjetin numerik.

Neni 28

Shpallja e procedurës së licencimit

1. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio numerike dhe/ose licencës së shërbimit të programit audio në faqen e internetit të AMA-s dhe tre nga gazetatat me tirazh më të lartë dhe në organet e shtypit, që qarkullojnë në zonën e përcaktuar të mbulimit.
2. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audio, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.
3. Aplikimet për licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimit të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

Neni 29

Tërheqja e dokumentacionit të konkurrimit

1. Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë transmetimi audio numerike dhe/ose licencës së shërbimit të programit audio duhet të pajisen me dokumentacionin e licencimit dhe të paraqesin aplikimin përkatës në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin për shpalljen e garës.
2. AMA miraton dokumentacionin që do t'u vihet në dispozicion subjekteve që do shfaqin interes për t'u licencuar, dokumentacioni i cili tërhiqet nga zyra e protokollit të AMA-s, pas kryerjes së pagesës së pakthyeshme në masën 1.000 lekë pranë Drejtorisë Ekonomike.
3. Ky dokumentacion përfshin:
 - i. Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio";
 - ii. Kushtet teknike të instalimit të paisjeve transmetuese për secilën zonë të shpallur; (Pika e transmetimit, kanali, fuqia e transmetuesit, etj.
 - iii. Kërkesat programore ;
 - iv. Pagesat për licencën, taksat etj, e llogaritura për zonën në fjalë.

Neni 30

Sqarimet mbi dokumentacionin e licencimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet e që kanë blerë dokumentacionin e konkurrimit mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA për dokumentacionin e licencimit.
2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e licencimit, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjektsh, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë blerë dokumentacionin e licencimit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

Neni 31

Aplikimi

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e licencimit.
2. Çdo subjekt aplikues i nënshtrohet kërkesave të parashikuara në nenin 62 të ligjit nr. 97/2013, mbi kufizimet e pronësisë në transmetimet audio. Mosrespektimi i detyrimit sipas këtij neni është kusht skualifikimi.
3. Dokumentacioni i aplikimit që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë përpara datës së aplikimit.
4. Aplikimi në çdo fletë duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
5. Dokumentacioni i aplikimit nuk i kthehet aplikuesit.

Neni 32

Kërkesa të përgjithshme

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio u jepet shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri aksionare janë nominative.
3. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.
4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.
5. Kushteve të mësipërme u nënshtrohen edhe licencat kombëtare për shërbimin e programit audio.
6. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio u jepet personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.
7. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.
8. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

9. Licenca kombëtare, rajonale ose lokale e transmetimit audio nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionarë të të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca me vendim të AMA-s.
10. Licenca kombëtare, rajonale ose lokale e transmetimit audio nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.

Neni 33

Kërkesat financiare

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio (rrjet + program) u jepet shoqërive aksionare që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/ autorizuar, në vlerën jo më pak 10.000.000 lekë.
2. Licenca kombëtare e shërbimit të programit audio u jepet shoqërive aksionare që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar në vlerën jo më pak 5.000.000 lekë.
3. Licenca rajonale ose lokale e transmetimit audio (rrjet+ program) u jepet subjekteve juridike që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/autorizuar, në vlerën jo më pak 2.500.000 lekë.
4. Licenca rajonale ose lokale e shërbimit të programit audio u jepet subjekteve juridike që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/ autorizuar, në vlerën jo më pak 1.000.000 lekë.
5. Subjekti aplikues:
 - 5.1 Për licencë transmetimi audio duhet të paraqesë garanci bankare në masën 10% të vlerës së kapitalit financiar të kërkuar. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar, duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit, për një periudhë prej:
 - a. 12 muajsh, për aplikimet për licencë kombëtare audio
 - b. 6 muajsh, për aplikimet për licencë rajonale ose lokale,
 - 5.2. Për licencë për ofrimin e shërbimit të programit audio duhet të paraqesë garanci bankare në masën 10% të vlerës së kapitalit të kërkuar për këtë licencë. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar, duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit, për një periudhë prej:
 - a. 12 muajsh, për aplikimet për licencë kombëtare ofrimi shërbimi të programit audio
 - b. 6 muajsh, për aplikimet për licencë rajonale ose lokale ofrimi shërbimi të programit audio,
 - 5.3. Garancia bankare ç'ngurtësohet para afatit në rast se:
 - a. Subjekti ka dalë në transmetim dhe ka kryer pagesën vjetore për licencë;
 - b. Subjektit i është refuzuar aplikimi për licencë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

6. Në rast se subjekti nuk ka dalë në transmetim dhe nuk ka kryer pagesën vjetore ndaj AMA-s, garancia bankare kalon në llogari të AMA-s në masën e detyrimit.

Neni 34

Kërkesat programore

1. Aplikuesit për licencë kombëtare, rajonale apo lokale të transmetimit audio dhe aplikuesit për licencë kombëtare të shërbimit të programit audio, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të garantojnë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tyre do të përmbushin standardet programore duke:
 - i. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit.
 - ii. Respektuar paanshmërinë, plotësinë e pluralizmin e informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinioneve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
 - iii. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
 - iv. Promovuar kulturën kombëtare shqiptare dhe gjuhën shqipe;
 - v. Promovuar kulturën evropiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat evropiane;
 - vi. Promovuar kulturën e pakicave kombëtare;
 - vii. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, radio-dramatizimeve dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare;
 - viii. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e RSH-së për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;
 - ix. Promovuar bashkëpronësinë dhe kolegjalitetin në vendimmarrjet editoriale;
 - x. Respektuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;
 - xi. Respektuar privatësinë e individit;
 - xii. Respektuar diversitetin fetar dhe racën;
 - xiii. Respektuar ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
 - xiv. Respektuar normat morale dhe etike të shoqërisë;
 - xv. Respektuar të drejtën e përgjigjes.
 - xvi. Respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve, në të gjitha llojet e programeve dhe në programe të posaçme audio për fëmijët.

Neni 35

Kërkesat teknike

Aplikuesit për licencë kombëtare të transmetimit audio duhet të plotësojnë kërkesat teknike, ku bëjnë pjesë:

- i. Plani i frekuencave të rrjetit numerik kombëtar, rajonal ose lokal, të miratuar nga AMA bazuar në Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve "Për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06), ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- ii. Standardet e transmetimit;
- iii. Pikat e transmetimit dhe fuqitë përkatëse të rrezatuara që përcaktojnë zonën e mbulimit;
- iv. Shërbimet shoqëruese dhe të dhëna të tjera të lidhura me to;
- v. Teknologjia e transmetimit;
- vi. Afati i përfundimit të ndërtimit të rrjetit.

Neni 36

Normat e mbulimit

Mbulimi me sinjal audio tokësore konsiderohet mbulimi me intensitet fushe jo më të vogël se:

- a. 70 dB μ V/m (mono) dhe 74 dB μ V/m (stereo) për qytete të mëdha
- b. 60 dB μ V/m (mono) dhe 66 dB μ V/m (stereo) për zona urbane
- c. 48 dB μ V/m (mono) dhe 54 dB μ V/m (stereo) për zona rurale
- d. 34 dB μ V/m (mono) dhe 48 dB μ V/m (stereo) për zona të thella

Neni 37

Shfrytëzimi i spektrit të frekuencave

Subjekti i licencuar për transmetime kombëtare, rajonale ose lokale audio, për përmirësimin e mbulimit të realizuar nga rrjeti i tyre brenda zonës së licencimit kanë të drejtë t'i kërkojnë AMA-s, frekuenca të tjera shtesë.

Neni 38

Dokumentacioni i aplikimit

1. Aplikuesit për licencë kombëtare, rajonale ose lokale transmetimi audio duhet të plotësojnë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

1.1 Të dhënat e aplikuesit:

- i. Regjistrimi në QKR me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionarëve me kuotat respektive;
- ii. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë listën e ortakëve të tij;
- iii. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera audio ose audiovizive.
- iv. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve të subjektit;
- v. Adresa, nr. tel, fax, e_d. mail;
- vi. Personi përfaqësues.

1.2 Kërkesa teknike:

- i. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit përfshirë mbulimin dhe interferencat;
- ii. Projektin dhe preventivin e rrjetit (a. skema e organizimit, b. projektet teknike të studiove; c. projektet teknike të pikave të transmetimit, d. karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese);
- iii. Projektin dhe preventivin e rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- iv. Cilësia e transmetimit për të gjithë programet që mbështeten në rrjet;
- v. Standardi i transmetimit (T-DAB)
- vi. Kapaciteti i transmetimit i lënë në dispozicion të të tretëve;
- vii. Afati i propozuar i përfundimit të rrjetit.

1.3 Kërkesat ekonomike:

- i. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i vërtetuar ose në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose nga një ekspert kontabël i miratuar/autorizuar;
- ii. Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat për periudhën e vlefshmërisë së licencës duke përcaktuar llojet e të ardhurave (reklama, të ardhura nga të tretët, të ardhurat nga shërbimi etj), shpenzimet fikse, të ndryshueshme, detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, origjinën dhe vlerën e investimeve që parashikohen të kryhen gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës);
- iii. Garancia bankare që vërteton se aplikuesi ka ngurtësuar shumën prej 10% të vlerës së kapitalit të kërkuar për një periudhë: a. deri 12 muaj për aplikimet për licencë kombëtare dhe b. 6 muaj për aplikimet për licencë rajonale ose rajonale, duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit;
- iv. Në rastin e aplikimit për licencë për ofrimin e shërbimit të programit audio duhet të paraqesë garanci bankare në masën 10% të vlerës së kapitalit të kërkuar për këtë licencë për një periudhë: (a) 12 muajsh, për aplikimet për licencë ofrimi shërbimi të programit audio dhe (b) 6 muajsh, për aplikimet për licencë ofrimi shërbimi të programit audio
- v. Lista e administratorëve,

1.4 Kërkesat programore:

- i. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen të jetë në përputhje me parimet themelore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesat e Kodit të Transmetimit të AMA-s.
- ii. Struktura programore e propozuar duhet të përmbajë, pavarësisht nga lloji i aplikimit për licencë kombëtare, rajonale apo lokale, të dhëna dhe raporte që, në tërësinë e tyre shprehin qartë pluralizmin dhe paanësinë e informacionit.
- iii. Të dhëna statistikore për programet audio të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe tematike (Informacion, kulturë, art, argëtim, zbavitje, dramatizim, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
- iv. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
- v. Programi javor i transmetimit;
- vi. Grila e strukturës programore;
- vii. Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë që garanton cilësinë e informacionit, promovimin e gjuhës e të kulturës kombëtare, larminë e programeve për fëmijë e të rinj, si dhe çështje specifike të traditës e zhvillimeve rajonale e lokale.

1.5 Të tjera:

- i. Të dhëna mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë;
- ii. Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- iii. Informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionarëve të saj;
 - iv. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit (për subjektet rajonale dhe lokale minimumi është 5 anëtarë, ndërsa për subjektet kombëtare minimumi është 9 anëtarë);
2. Aplikuesi për licencë kombëtare, rajonale ose lokale të shërbimit të programit audio, duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara pikat 1.1, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, si dhe kërkesat e mëposhtme teknike:
- i. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave;
 - ii. Cilësia e transmetimit për programet e mbështetura.
 - iii. Afati i propozuar i daljes në transmetim.
3. Aplikuesi duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.
4. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.

Neni 39

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për licencë transmetimi audio

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën vlerësimin me pikë të çdo aplikimi për licencë transmetimi kombëtare, rajonale ose lokale audio:

1. Kompozimi i programeve të vetë,	10 (pikë)
I ndarë në:	
1. Programe të Përgjithshme	2 njësi për 1 program
2. Lajme	2 njësi për 1 program
3. Fëmijë	5 njësi për 1 program
4. Rini	2 njësi për 1 program
5. Shkencë	2 njësi për 1 program
6. Sport	2 njësi për 1 program
7. Radio dramatizime	2 njësi për 1 program
8. Produksione Shqip	2 njësi për 1 program
9. Muzikë	1 njësi për 1 program
10. etj	1-4 njësi sipas rastit për 1 program

Gjatë vlerësimit numri i programeve të propozuara sipas secilës tematikë shumëzohet me njësitë e mëposhtme. Shuma e rezultateve quhet TN (totali i njësive).

Konvertimi i njësive në pikë bëhet sipas formulës së mëposhtme:

$$p = \Sigma N / 30 * 10$$

P= pikë,

ΣN = shuma totale e njësive

r= shuma totale e njësive të vlerësuara

Në rast se rezultati i p del më i lartë se 10, numri i pikëve llogaritet në 10 pikë.

2. Struktura programore 10 pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Vlerësimi i strukturës programore të paraqitur do të kryhet për çdo shërbim programor, sipas njësive që përcaktohen më poshtë:

2.1 Programe të përgjithshme

2.1.1 Programe informative	2 njësi
2.1.2 Programe për fëmijë	3 njësi
2.1.3 Program për minoritetet	2 njësi
2.1.4 Programe edukative	3 njësi
2.1.5 Programe të aktualitetit	2 njësi
2.1.6. Radio dramatizime	2 njësi
2.1.7 Programe argëtuese	2 njësi
2.1.8 Quiz	2 njësi
2.1.9 Programe sportive	2 njësi
2.1.10 etj	2 njësi
TOTALI	22 njësi

2.2 Programe tematike:

2.2.1 Programe informative	5 njësi
2.2.2 Program për fëmijë	10 njësi
2.2.3 Larmia brenda tematikës	5 njësi
2.2.4 etj	2 njësi
TOTALI	22 njësi

2.3 Vlerësimi i tërësisë së programeve të veta të mbështetura në rrjetin numerik bëhet si më poshtë:

- Mblidhen njësitë e grumbulluara gjatë vlerësimit të çdo shërbimi programor (të përgjithshëm dhe tematik), e cila quhet shumatore e njësive (ΣN).
- Numri i njësive maksimale për çdo program është 308 njësi llogaritur për 14 programe ($14 \cdot 22$ njësi për program)
- Llogaritja e pikës bëhet sipas formulës:
$$P = \Sigma N / 308 \cdot 10$$

3. Vlerësimi i aftësive teknike

40 pikë

- Projekti teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave dhe preventimin përkatës hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor). 15 pikë
- Plani i mirëmbajtjes së rrjetit 5 pikë
- Projekti dhe preventivi i rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP, hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor). 5 pikë
- Cilësia e transmetimit për të gjithë programet që mbështeten në rrjet, 5 pikë
- Kapaciteti i transmetimit i lënë në dispozicion të të tretëve, 5 pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 2.6. Afati i propozuar i përfundimit të rrjetit, duke specifikuar planin e implementimit, 5 pikë
4. Vlerësimi i kriterëve financiarë 20 pikë
- a. Fuqia ekonomike që rezulton nga kapitali themeltar i aplikuesit 10 pikë;
 - b. Kapaciteti i vetëfinancimit gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës 5 pikë;
 - c. Investimet teknologjike që parashikohen të kryhen 5 pikë;
5. Vlerësimi i burimeve njerëzore 20 pikë, nga të cilat
- 5.1. Numri i punonjësve 8 pikë;
 - 5.2. Cv e punonjësve të firmosura, gjithëpërfshirëse 6 pikë
 - 5.3. Mënyra e organizimit (organizograma) 6 pikë;

Neni 40

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për licencë shërbimi programi audio

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën vlerësimin me pikë të çdo aplikimi për licencë kombëtare, rajonale ose lokale të shërbimit të programit audio duke u mbështetur në këto kriterë:

1. Struktura programore 50 pikë
- 1.1 Program i përgjithshëm 50 pikë
- 1.1.1 Programe informative 8 njësi
 - 1.1.2 Programe për fëmijë 8 njësi
 - 1.1.3 Program për minoritetet 6 njësi
 - 1.1.4 Programe edukative 8 njësi
 - 1.1.5 Programe të aktualitetit 6 njësi
 - 1.1.6. Radio – dramatizime 6 njësi
 - 1.1.7 Programe argëtuese 6 njësi
 - 1.1.8 Quiz 6 njësi
 - 1.1.9 Programe sportive 6 njësi
 - 1.1.10 Të tjera 6 njësi
 - TOTALI 66 njësi**
- 1.2 Program tematik: 50 pikë
- 1.2.1 Informacion 12 njësi
 - 1.2.2 Program për fëmijë 10 njësi
 - 1.2.3 Larmia brenda tematikës 30 njësi
 - 1.2.4 etj 8 njësi
 - TOTALI 60 njësi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 1.3 Vlerësimi i secilit prej shërbimeve programore bëhet si më poshtë:
- a. Mblidhen njësitë e grumbulluara gjatë vlerësimit të çdo programi e cila quhet shumatore e njësive (ΣN).
 - b. Numri i njësive maksimale për çdo program është 66 njësi për programet e përgjithshme dhe 60 njësi për programin tematik.
 - c. Llogaritja e pikëve bëhet sipas formulës:
Për programin e përgjithshëm
 $P = \Sigma N / 66 * 60$
Për programin tematik
 $P = \Sigma N / 60 * 60$
2. Vlerësimi i aftësive teknike 10 pikë
- 2.1 Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave; 5 pikë
 - 2.2 Cilësia e transmetimit për të gjithë programet që mbështeten në rrjet; 2 pikë
 - 2.3 Afati i propozuar i daljes në transmetim. 3 pikë
3. Vlerësimi i kriterëve financiarë 20 pikë
- a. Fuqia ekonomike që rezulton nga kapitali themeltar i aplikuesit 10 pikë;
 - b. Kapaciteti i vetëfinancimit gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës 10 pikë;
4. Vlerësimi i burimeve njerëzore 20 pikë, nga të cilat
- 4.1. Numri i punonjësve dhe (përshkrimi i detyrave të të punësuarve) 8 pikë;
 - 4.2. Cv e punonjësve (gjithëpërfshirëse) 6 pikë
 - 4.3. Organigrama, mënyra e organizimit 6 pikë;

Neni 41

Afati i licencës së transmetimit audio

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio jepet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi.
2. Licenca rajonale dhe lokale e transmetimit audio jepet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi.
3. Licenca kombëtare e shërbimit të programit audio jepet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi.
4. Licenca rajonale dhe lokale e shërbimit të programit audio për një afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi.

Neni 42

Rinovimi i licencës

1. Aplikimi për rinovimin e licencës së transmetimit audio duhet të bëhet të paktën 90 ditë përpara përfundimit të afatit të licencës.
2. Kërkesat e aplikimit për rinovimin e licencës së transmetimit audio janë të njëjta me atë të aplikimit fillestar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

3. Autoriteti i Mediave Audiovizive refuzon aplikimin e subjektit i cili:
- a) nuk ka respektuar kushtet e licencës gjatë periudhës së licencimit;
 - b) është debitor lidhur me detyrimeve financiare të rrjedhura nga licenca;
 - c) është debitor si rrjedhojë e dënimit me sanksion gjobë, të formës së prerë të pashlyer.

Neni 43

Zgjerimi ose zvogëlimi i zonës së licencimit

3. Kërkesat e aplikimit për zgjerimin, ose zvogëlimin e zonës së licencimit të transmetimit audio janë të njëjta me atë të aplikimit fillestar.
4. Aplikimet shqyrtohen në përputhje me planin e përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio analoge, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF).

Neni 44

Detyrimi për daljen në transmetim

I licencuari për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokale duhet të respektojë kërkesën e parashikuar në nenin 69 të ligjit nr. 97/2013, për daljen në transmetim.

Neni 45

Detyrimet financiare

1. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose rajonal, do të kryhen bazuar në vendimin nr. 4, datë 22.05.2013 të Autoritetit të Mediave Audiovizive. të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe vendimin nr. 6, datë 22.05.2013 “Për miratimin e pagesave për shërbime që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.
2. Pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatëvonesë në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditëvonesë por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.
3. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal, mund të jenë objekt ndryshimi me vendim të Autoritetit të Mediave Audiovizive në përputhje me legjislacioni në fuqi në fushën e mediave.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 46

Shqyrtimi i aplikimeve të bëra përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje

1. Aplikimet për rinovimin e licencës së transmetimeve audio, të bëra para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, për që, për të cilat ende nuk është marrë një vendim, do të shqyrtohen do



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

të shqyrtohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë qenë në fuqi në datën e paraqitjes së aplikimeve.

2. Pavarësisht përcaktimit të pikës 1 këtij neni, licenca e këtyre subjekteve radiofonike privatë vendorë do të rinovohet për një afat 5 vjeçar.

Neni 47

Parashikime të fundit

1.Çdo akt nënligjor i miratuar nga Autoriteti i Medias Audiovizive që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.

Neni 48

Hyrja në fuqi

1.Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare në internet të Autoritetit të Mediave Audiovizive.